



REPUBLIKA E KOSOVËS		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20/DPK	Nr. Prot.	01-562/16
Dep.		Br. Prot.	
Nr. llog.		Prot. No.	
Broj stranica	02	Data	10.02.2016
Nr. pages		Date	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.02.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3955/15, për z. Avdi Mjeku – Drejtor i Drejtorisë për Inspektorat në Komunën e Obilqit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3955/15, për z. Avdi Mjeku – Drejtor i Drejtorisë për Inspektorat në Komunën e Obilqit, dhe njëkohësisht pronar aktiv në biznesin privat “GESA - VA”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e AKK-së.

z. Mjeku është njoftuar se nuk mund të jetë pronar aktiv në biznes privat, krahas ushtrimit të funksionit të zyrtarit të lartë publik, ndërsa ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit duke mbyllur biznesin privat, për të vazhduar ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka mbyllur biznesin privat "GESA - VA". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

